

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist** pranë OSSH / Departamenti i Kontrollit dhe Rekuperimit të Humbjeve / Drejtoria e Eficiencës së Energjisë / Sektori I Kontrollit të Paneleve.

SPECIALIST

Specialisti pranë Sektorit të Kontrollit të Paneleve është përgjegjës për kontrollin teknik, verifikimin, testimin dhe monitorimin e paneleve elektrike, me qëllim garantimin e funksionimit të sigurt, efikas dhe në përputhje me standardet teknike dhe rregulloret në fuqi. Siguron cilësinë e instalimeve, përputhshmërinë me dokumentacionin teknik dhe raportimin periodik të proceseve të kontrollit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kontrollon, teston dhe verifikon panelet elektrike për të garantuar funksionimin e tyre të sigurt dhe efikas.
- Verifikon dokumentacionin teknik të paraqitur nga subjektet, individët apo operatorët përkatës për panelet elektrike.
- Kontrollon saktësinë e montimit, instalimit dhe lidhjeve teknike të paneleve sipas standardeve dhe specifikimeve teknike.
- Evidenton dhe dokumenton çdo problematikë teknike, devijim apo mospërputhje dhe ia referon Shefit të Sektorit.
- Kontrollon cilësinë e paneleve në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë (IEC, ISO, etj.).
- Kryen kontrole periodike dhe inspekte në terren sipas planit të punës së miratuar.
- Përgatit raporte teknike mbi rezultatet e kontrolleve dhe propozon masa për përmirësimin e performancës dhe sigurisë së paneleve.
- Monitoron respektimin e procedurave teknike gjatë instalimit dhe mirëmbajtjes së paneleve elektrike.
- Bashkëpunon me strukturat e tjera teknike për zgjidhjen e problematikave të konstatuara gjatë kontrollit.
- Raporton periodikisht mbi mbarëvajtjen e punës dhe harton planin e kontrolleve pranë eprorit direkt.
- Siguron zbatimin e rregullave të shëndetit dhe sigurisë në punë gjatë proceseve të kontrollit dhe testimit.
- Kryen çdo detyrë tjetër funksionale që i ngarkohet nga eprori, në përputhje me nevojat e sektorit dhe legjislacionin në fuqi.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Diplomë universitare në Inxhinieri Elektrike, Elektroteknikë, Energjetikë ose fusha të ngjashme.
- Eksperiencë pune në kontrollin, mirëmbajtjen ose testimin e sistemeve elektrike përbën avantazh.
- Njohuri të mira mbi panelet elektrike, standardet teknike dhe rregulloret e sigurisë elektrike.
- Njohuri mbi standardet IEC, ISO dhe praktikat e kontrollit teknik.
- Aftësi të mira analitike dhe raportuese.
- Aftësi bashkëpunimi dhe komunikimi profesional.
- Përdorim i mirë i paketës Microsoft Office dhe dokumentacionit teknik.
- Integritet profesional dhe korrektësi në zbatimin e detyrave.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.